

**Konferenca Kombëtare
"Ndërtimi i një mjedisi
pa barriera dhe e drejta
e përfshirjes së
njerëzve me aftësi të
kufizuara në të gjithë
sektorët e jetës"**



Faqe 6

**"Raport vëzhgimi
"Politika dhe
aftësia e kufizuar"**

Faqe 5



**Mjete Lëvizëse e
Rehabilitim për
Personat me Aftësi të
Kufizuara në Shqipëri**

Faqe 4



**Respektimi i të drejtave
elektorale për personat me
aftësi të kufizuara**

Faqe 2



**Të drejtat e grave dhe vajzave
me aftësi të kufizuara**

Faqe 2

Të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara

Në kuadrin e programit me fokus "Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore", të filluar në Nëntor 2008, me mbështetjen e "Agjencisë së Ndhmës për Zhvillim Nërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës - USAID", FSHDPAK ka realizuar gjatë vitit 2009 një sërë aktivitetesh.

Grupi i Grave me aftësi të kufizuara

FSHDPAK në fillim të vitit 2009 inicioji ngritjen e "Grupit të Grave intelektuale me aftësi të kufizuara" në Tiranë me përfshirjen e 11 grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe në Shkodër "Klubin e Grave me Aftësi të Kufizuara". Kjo nisëm e inicjuar nga FSHDPAK synon në fuqizimin e grave me aftësi të kufizuara për të qenë më aktive në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre, si edhe për t'u bërë pjesë e çdo nisme në kuadrin politikash dhe dokumentash ligjor të hartuara në nivel kombëtar apo rajonal.

Raporti "Gratë me aftësi të kufizuara në Shqipëri – të përfshira apo të harruara" dhe Draft platforma e Grupit të Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara

Nisma e ngritjes së grupimeve të grave intelektuale në Tiranë dhe në Shkodër luajti një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave për hartimin e raportit mbi situatën e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Ndërkohë përmes takimeve që zhvilluan, anëtarët e këtyre grupimeve ngritën problematika dhe përgatitën një draft platformë për

qeverinë, me rekomandime të nxjerra nga analiza e gjendjes së grave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Mbi bazën e rekomandimeve që ky grupim përcolli si edhe të dhënat e mbledhura nga FSHDPAK në 6 rajone të vendit mbi situatën e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, u hartua raporti i studimit "Gratë me aftësi të kufizuara në Shqipëri – të përfshira apo të harruara".

Konferenca kombëtare për të drejtat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara

FSHDPAK në 26 Maj 2009 realizoi të parën "Konferencë Kombëtare për të drejtat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara" me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve, organizatave në fushën e të drejtave, organizata të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara. Në këtë konferencë që u organizua në seksione sipas fushave të Strategjisë Kombëtare të personave me aftësi të kufizuara moderatore ishin vetë vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara, ku një vend të rëndësishëm zuri prezantimi i dy materialeve – Raporti "Gratë me aftësi të kufizuara në Shqipëri – të përfshira apo të harruara" dhe Draft platforma e Grupit të Grave Intelektuale me Aftësi

të Kufizuara. Në përfundim të kësaj konferencë pjesëmarrësit propozuan një sërë rekomandimesh për plotësimin e Draft-Platformës e cila do t'i dërgohet Qeverisë Shqiptare me kërkesën për të hartuar një plan veprimi për përmirësimin e situatës së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara.

Ndërgjegjësimi publik

Grupimi i vajzave dhe grave intelektuale me aftësi të kufizuara në Qershor 2009, përmes një emisioni në një nga oraret më të shikuara në Tv "News 24", përcolli mesazhin se gratë me aftësi të kufizuara përjetojnë format më të rënda të diskriminimit, por ato kanë vlera dhe duhet të jenë pjesë e të gjitha programeve të zhvillimit.

Për ngritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile për të mbështetur këtë nismë u zhvilluan dy trajnime- në Tiranë dhe në Shkodër. Gjithashtu u përgatitën dhe u shfaqën një dokumentar dhe një spot televiziv ku gra dhe vajza me aftësi të kufizuara, të intervistuar në aktivitetin e përditshëm të tyre bëjnë thirrje që t'u ofrohen shanse të barabarta të gjitha grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje shoqërore.

Grupi i Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara do të vijojë punën me intensifikim e fushatës së avokatisë në mbrojtje të të drejtave të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara përmes takimeve me gratë deputete të parlamentit të ri, me organizatat e grave dhe organizatat e tjera kombëtare e ndërkombëtare si edhe do të përgatisë Platformën përfundimtare për qeverinë me prioritetet për ndërhyrje për përmirësimin e jetesës për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, të cilën do tua dorëzojë në një seminar përfaqësuesve të MPÇSSH.





Respektimi i të drejtave elektorale për personat me aftësi të kufizuara

Bashkëpunim me Institutin Republikan Ndërkombëtar - IRI

FSHDPAK, duke punuar me organizata të personave me aftësi të kufizuara, ka vazhduar përpjekjet për përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në programet politike dhe elektorale të subjekteve zgjedhore, mbështetur dhe në bashkëpunim me IRI. FSHDPAK ka zhvilluar fushata intensive avokatie, lobimi e ndërgjegjësimi përmes takimeve në nivelet më të larta të vendimarrjes dhe ekzekutivit, të strukturave zgjedhore, të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të 28 Qershorit 2009; përmes korespondencës së vazhdueshme me këto subjekte; përmes deklaratave dhe prononcimeve në Media. FSHDPAK ofroi bashkëpunimin në organizimin e trajnimit të ekspertit të IRI për ngritjen e kapaciteteve advokuese të organizatave të aftësisë së kufizuar për t'u përgatitur për zgjedhjet parlamentare të Qershorit 2009.

Përfaqësues të FSHDPAK morën pjesë në takimet që IRI organizoi me kryeministrin z. Sali Berisha, me kryetarin e KQZ z. Arben Ristani, ku sëbashku me Drejtorin për Europën z. Jan Surotchak, ku bënë prezente domosdoshmërinë e zbatimit të Platformës së Aftësisë së kufizuar, veçanërisht për marrjen e masave dhe për krijimin e aksesit për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi të

kufizuara. Përfaqësuesit e FSHDPAK dhe IRI, z. Nesti Gjeluçi dhe Mr. Patric Sheehan zhvilluan takime me kryetarin e Këshillit Kombëtar të Çështjeve të Aftësisë së Kufizuar, z. Genc Pollo dhe Ministrin e Ministrisë së Brëndshme, z. Bujar Nishani ku u prezantuan synimet për nxitjen e zbatimit të Kodit Zgjedhor në lidhje me pjesëmarrjen në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Takime ndërgjegjësuese u zhvilluan edhe në komisionet

parlamentare ku u theksua që respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, fillon nga e drejta e votës dhe shtrihet në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Takime u zhvilluan edhe me përfaqësues të partive politike. U përgatit dhe u shpërnda një raport mbi hapësirat në media të problematikës së aftësisë së kufizuar në fushatën para zgjedhore të Qershorit 2009. Kjo u monitorua nga FSHDPAK, me angazhimin e një studenteje tetraplegjike.

Për të katërtën herë zgjedhësit me aftësi të kufizuar u përfshinë në grupin e vëzhguesve, të organizuar nga FSHDPAK, për monitorimin e këtyre zgjedhjeve. Mbi bazën e të dhënave të mbledhura prej tyre u hartua dhe u shpërnda raporti i monitorimit me rekomandimet për strukturat përgjegjëse.

Si rezultat i përpjekjeve advokuese dhe lobuese të FSHDPAK, për herë të parë KQZ planifikoi një fond mod-est për ndërtimin e rampave në disa objekte publike në Tiranë – qendra votimi, ku votues ishin edhe zgjedhës me aftësi të kufizuara.

Fondacioni VODAFONE mbështet personat në nevojë për karrige me rrota në Shqipëri

Fondacioni Vodafone, në vazhdimësi mbështeti Fabrikën e Prodhimit të Karrigeve me Rrota, Mirësia, në identifikimin, prodhimin, shpërndarjen e trajnimit të 90 personave në nevojë për karrige me rrota. Përmes mbështetjes së tij, Fondacioni Vodafone, u mundësoi 90 individëve në nevojë kushte dhe mundësi më të mira për të luajtur një rol aktiv dhe kontribuar si të barabartë në komunitetet e tyre. Një nga impaktet e drejtpërdrejta të kësaj mbështetjeje, është edhe siguri i mundësive për punësim për personat me aftësi të kufizuara, të punësuar në Fabrikën Mirësia, e cila funksionon nën kornizën e një biznesi social. Përmes

kësaj mbështetjeje, Fondacioni Vodafone tregoi edhe një herë se është një biznes i përgjegjshëm dhe funksionon në mbështetje të grupeve në nevojë.



Hapa të mëtejshëm për një zhvillim gjithpërfshirës

“Koalicioni Shqiptar - Aftësia e Kufizur dhe Zhvillimi (DDCA)”, mbështetur nga World Learning Forecast / USAID, vijoi edhe gjatë vitit 2009 aktivitetet e tij për të realizuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe për të realizuar përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në iniciativat dhe programet e zhvillimit në Shqipëri. Një fushatë e vazhdueshme avokatie e lobimi për mbrojtjen e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara; kundër diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara mendore; për të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, u shoqërua me takime të përfaqësuesve të DDCA me drejtues të institucioneve përgjegjëse.

U përgatitën dhe shpërndanë dy edicione të Buletinit Informativ. U

përgatit dhe funksionon faqja e internetit e DDCA www.ddca-al.org.

Disa aktivitete dhe rezultate të DDCA

U zhvillua një takim i DDCA, në prill 2009, ku anëtarëve iu prezantua raporti i aktivitetit një vjeçar të DDCA. Në këtë takim, dy të ftuar nga KQZ, bënë prezente tek pjesëmarrësit masat që KQZ po ndërmerre, në përgjigje të thirrjes së DDCA, për të siguruar pjesëmarrjen në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara në zgjedhjet e 28 Qershorit 2009.

Mbështetja nga DDCA i procesit të vazhdueshëm të avokatisë së FSHDPAK, bënë që në Ligjin e Planifikimit të Territorit që u miratua në Prill 2009, të zinin vend të gjitha rekomandimet e bëra nga ekspertët e FSHDPAK për një territor të

përshtatur për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara.

DDCA shpërndau një deklaratë duke theksuar që problematikat e Personave me aftësi të kufizuar duhet të jenë pjesë e prioritetëve në programet politike dhe elektorale të partive politike në Shqipëri

Dy anëtarë të DDCA, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe ADRF mbështetën me një deklaratë të përbashkët grevën e urisë së shoqatës së para e tetraplegjikëve të Shqipërisë.

Inisiativa për ngritjen dhe zhvillimin e Koalicionit Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi është konsideruar realisht e dobishme dhe përfituese nga anëtarët e DDCA. Një nga anëtarët, GTZ, duke përdorur këtë eksperiencë, e ka shtrirë atë në nivel lokal dhe ka iniciuar dhe mbështetur ngritjen e dy forumeve lokale, në Shkodër dhe Korçë. Gjithashtu iniciativa është konsideruar realisht e dobishme dhe përfituese edhe nga organizata Word Vision e cila paraqiti kërkesën për anëtarësim në DDCA, kërkesë e cila u pranua nga të gjithë anëtarët.

Organizata “Save the Children” ftoi anëtarët për t’u bashkuar me nismën për përgatitjen e rekomandimeve dhe përmirësimin e Dispozitave Normative të Arsimit. Këto rekomandime i’u paraqitën Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Më nismën u bashkuan, duke ofruar kontributin e tyre FSHDPAK, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Avokati i Popullit.

FSHDPAK prezantoi nismën për fuqizimin e një grupi grash me aftësi të kufizuar për të qenë më aktive për mbrojtjen e të drejtave të këtij grupimi, si edhe për t’u bërë pjesë e nismave të grupimeve të ndryshme për të drejtat e grave si edhe për të ndërmarrë nisma të reja në mbështetje të grave me aftësi të kufizuara të cilat janë dyfish të diskriminuara

Mjete Lëvizëse e Rehabilitim për Personat me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri

Prej Prillit 2009, FSHDPAK ndërmori një tjetër iniciativë fokusuar në realizimin e të drejtës për lëvizje për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Një program, me një kohëzgjatje tre vjeçare, do të ndikojë në qëndrueshmërinë e Fabrikës së prodhimit të karrigeve me rrota Mirësia, por edhe do t’u vijë në ndihmë përpjekjeve për rehabilitim e përfshirje të personave me aftësi të kufizuara, specifikiisht në zonat rurale të vendit.

Një nga synimet e programit është edhe ndryshimi i politikave e kuadrit ligjor në vend, në mbështetje të personave në nevojë për karrige me rrota, por edhe mjete të tjera ndihmëse për lëvizje.

Programi financohet nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, USAID, përmes World Learning.



Politika dhe Aftësia e Kufizuar

Projekti "Promovim i ndryshimit në platformat politike përmes dialogut, ndërmjet personave me aftësi të kufizuara dhe politikanëve" ka qënë një iniciativë e parë e këtij lloji në Shqipëri e ndërmarrë nga FSHDPAK me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky projekt pati si qëllim nxitjen e avokatisë konsistente pranë organeve qeverisëse dhe ligjvënëse për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri si dhe fuqizimin e mardhënies shoqëri civile me fokus aftësinë e kufizuar - parti politike, nëpërmjet njëserë aktivitetesh të realizuar në gjatëmujorin e parë të 2009.

Raport vëzhgimi "Politika dhe aftësia e kufizuar"

Si një nga iniciativat e para e këtij lloji në Shqipëri, në përputhje me objektivat e projektit, u realizua një studim vëzhgimi për vlerësimin se Sa dhe Si partitë politike në Shqipëri reflektojnë në programet e tyre politike dhe elektorale nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe problematikat e tyre. Sa ato njohin kuadrin politik dhe ligjor vendas dhe ndërkombëtar në mbështetje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara; qëndrimet për pjesmarrje të tyre në jetën politike të vendit si dhe perspektiva e tyre për zgjidhje të problematikave të kësaj kategorie si: punësimi, arsimit, përshtatshmëria, shërbimet sociale - shëndetësore, e drejta e votës.

Ndërgjegjësimi i spektrit politik

Të përfshirë në projekt për problematikën e aftësisë së kufizuar, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; kuadrin ligjor ekzistues në Shqipëri si dhe politikat aktuale qeverisëse në mbështetje të tyre, ishte një objektiv tjetër themelor i zbatimit të këtij projekti. Informacioni i përgatitur dhe shpërndarë

Zbatimi i projektit ishte një mundësi e mirë për kontakte të vazhdueshme dhe të organizuara me spektrin politik në vend, për ti ndërgjegjësuar ata për problematikat e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri si dhe problematika adekuate në përputhje me zhvillimet politike dhe ligjore të ndodhura në kohën kur projekti gjeti zbatim



per perfaqësues të katër partive politike, trainimet e zhvilluara me pjesmarrjen e përfaqësuesve të tyre të përfshira në projekt me tematikë kryesore "Aftësia e kufizuar dhe Barazia", modul i cili përfshinte trajtimin e çështjeve si; etika dhe terminologjia për aftësinë e kufizuar, modeli social si favorzues ndaj atij mjekësor, te drejtat e njeriut dhe aftësia e kufizuar, qenë instrumentat e përdorur për të mundësuar njohjen e përfaqësuesve të politikës me problematikën e aftësisë së kufizuar dhe vlerësimin e saj si çështje e të drejtave të njeriut.

Nxitja dhe inkurajimi i individëve me aftësi të kufizuar

Për të patur zërin e tyre në vendimarrjet politike të vendit, personave

me aftësi të kufizuara duhet t'u garantohet e drejta për të marre pjesë në proceset elektorale, që do të thotë krijimi i të gjitha kushteve të nevojshme në përputhje me specifikat e tyre për pjesmarrje të plotë në zgjedhje. Trainimi 5 ditor i zhvilluar me përfaqësues të përzgjedhur nga organizata aktive të fushës së aftësisë së kufizuar me tematika komunikimin, leadershipin, ndërtimin e partnershipeve dhe dialogut si dhe avokati për pjesmarrje aktive në politikë mundësuan krijimin e nje grupi të personave me aftësi të kufizuar të informuar dhe me potenciale aktive për të lobuar dhe negociuar me faktorin politik për çështje të aftësisë së kufizuar në Shqipëri.

Vendosja e dialogut ndërmjet shoqërisë civile e partive politike

Të fokusuar në çështjet e aftësisë së kufizuar, individëve me aftësi të kufizuar dhe përfaqësuesve të katër partive politike (PD, PS, LSI, PDK) të përfshira në projekt për diskutuar dhe debatuar rreth problematikave të aftësisë së kufizuar u arrit përmes takimeve të vazhdueshme të organizuara, seminareve me pjesmarrjen e të gjithë aktorëve të përfshirë në projekt. Projekti garantoj si vendosjen ashtu edhe qëndrueshmërinë e këtij dialogu në të ardhmen.

Takimet me Drejtues të grupeve parlamentare, Kryetarë të Komisioneve parlamentare për çështjet ligjore ato të Reformës Zgjedhore, Drejtues të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve krijuan mundësi për vendosjen e një dialogu konstruktiv. Kjo u mundësua me marrjen në konsideratë të shumë sygjërimeve dhe rekomandimeve të dërguara në formën e korespondencës pranë këtyre institucioneve. Dialogu dhe shkëmbimi reciprok i eksperiencës mund të konsiderohet i sukseshëm pasi drejtues të partive politike kërkuan ekspertizën e FSHDPAK për çështje të aftësisë së kufizuar në procesin e hartimit të platformave elektorale.

Promovimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara

FSHDPAK gjatë këtyre viteve ka pasur rolin kryesor në procesin e nxitjes së hartimit dhe aprovimit të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Prej Janarit 2009, Komisioni Europian në kuadrin e Instrumentit Europian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut, po mbështet FSHDPAK për zbatimin e projektit me fokus promovim dhe mbrojtje të të drejtave të personave

me aftësi të kufizuara.

Përmes këtij projekti, FSHDPAK synon të nxisë zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara nga insitucionet përgjegjëse. Aktivitetet e projektit do të promovojnë strategjinë në nivel qendror dhe lokal.

Trajnimet, seminarët, fushatat ndërgjegjësuese si dhe konsulenca dhe ekspertiza në vazhdimësi nga profesionistë të fushës, ku një vend

të veçantë zënë vetë personat me aftësi të kufizuara, do të luajnë një rol të rëndësishëm në adaptimin e strategjisë në plane veprimi për zbatimin e saj në nivele lokal. Monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara nga Shoqëria Civile, synon të nxisë llogaridhënien e Qeverisë Shqiptare, të rrisë ndjenjën e përgjegjësive dhe përkushtimin e agjencive qeveritare dhe jo qeveritare për përfshirjen e problematikes së aftësisë së kufizuar në axhendat e reformave, për të sfiduar në këtë mënyrë përjashtimin social dhe për të promovuar gjithëpërfshirjen.

Iniciativa ligjore për plotësimin me mjete lëvizëse rehabilituese

Në programin ligjor një numër i madh rastesh që drejtohen për këshillim ligjor kanë sjellë gjithnjë në rritje kërkesat për mjete lëvizëse (karrige me rrota, paterica, deambulatorë etj...) si një nga mjetet bazë të integritit të tyre në shoqëri. Pavarësisht faktit që kuadri ligjor Shqiptar parashikon plotësimin e kërkesave të individëve me mjete lëvizëse nëpërmjet skemës së sigurimeve shoqërore dhe shërbimit social, këto skema nuk kanë funksionuar në praktikë prej vitesh tashmë.

Të gjendur përballë ankesave gjithnjë në rritje dhe problematikave ligjore që ka sjellë mosplotësimi i kërkesave për mjete lëvizëse, Programi ligjor në bashkëpunim me programin e Avokacisë pranë FSHDPAK ka ndërmarrë iniciativën për përmirësimin e kuadrit ligjor, duke lobuar me qeverinë Shqiptare dhe ministrinë e linjës në këtë fushë. Nëpërmjet kësaj iniciative FSHDPAK synon të ndikojë në përmirësimin e kuadrit ligjor në mënyrë që mjetet lëvizëse apo mjeteve të tjera ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara, të ofrohen si pjesë e paketës bazë shëndetësore, praktikë që ndiqet

tashmë nga një pjesë e madhe e vendeve europiane. Në këto kushte, nisur edhe nga reformat që po ndërmen nga Qeveria Shqiptare, për reformimin e shërbimit shëndetësor, një analizë e hollësishme e kuadrit aktual ligjor dhe propozimet për ndryshime ligjore i janë paraqitur në Prill 2009 Ministrisë të Punës

Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabara, Insitituti të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Ky proces tashmë është në ndjekje të ekspertëve të FSHDPAK, por në mënyrë të veçantë kërkon bashkëpunimin dhe lobimin edhe shoqatave të tjera të personave me aftësi të kufizuara.

Konferenca Kombëtare "Ndërtimi i një mjedisi pa barriera dhe e drejta e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët e jetës"

Në Janar 2009 u zhvillua Konferenca Kombëtare "Ndërtimi i një mjedisi pa barriera dhe e drejta e përfshirjes së njerëzve me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorët e jetës", e planifikuar nga MPPTT në bashkëpunim me ADRF, me mbështetjen e World Learning Forecast/ USAID. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të strukturave përgjegjëse, qendrore e vendore, aktorë të tjerë nga sektorët publikë dhe të biznesit, si edhe përfaqësues të shoqatave të aftësisë së kufizuar. ADRF luajti një rol të veçantë në mbështetje të MPPTT për organizimin e kësaj konference si edhe gjatë zhvillimit të saj, duke orientuar diskutimet në lidhje me kërkesat e PAK për gjetjen e mënyrave dhe mjeteve që duhen përdorur nga aktorët përgjegjës për të zbatuar legjislacionin në këtë fushë.





Në Shqipëri ende mbetet problematike ofrimi i arsimit për të gjithë fëmijët pa dallim. Problematike paraqitet jo vetëm

Agustini tashmë në shkollë

arsimi gjithëpërfshirës, por nga ana tjetër edhe mungesa e infrastrukturës të shkollave për ofrimin e një mjedisi të përshtatur për nxënësit me aftësi të kufizuar fizike. Në një situatë të tillë problematike është ndeshur për vite me rradhë Agustini. Ai është 13 vjeç dhe nuk ka shkuar ndonjëherë në shkollë. Përfshirja në disa nga programet e përfitimit nga FSHDPAK nxiti dëshirën e tij për të vazhduar shkollën.

Në këtë mënyrë FSHDPAK bëri të mundur koordinimin për rregjistrimin e tij në njërën prej shkollave 9-vjeçare pranë zonës së banimit të Agustinit, për të cilat nuk ishte e lehtë negociimi. Tashmë Agustini është i rregjistruar në shkollën "28 Dhjetori"

në Laprakë, Tiranë. Por vështirësitë për sistemimin e tij në shkollë nuk mbaruan këtu, ambjenti arkitektonik urban ishte tërësisht i pafavorshëm për Agustinin, i cili është përdorues i karriges me rrota. Mos përshtatshmëria arkitektonike e bënte tejet të vështirë të shkuarin në shkollë të Agustinit, ç'ka kërkonte transportimin e tij çdo ditë. Pavarësisht lobimit për të mbështetur transportin e Agustinit nga kompani private, sigurimi i fondeve të përshtatshme për këtë qëllim ishte i pamundur, si rrjedhim stafi i FSHDPAK vendosi të kontribuojë mbi baza vullnetare për transportin e Agustinit deri në gjetjen e një zgjidhje tjetër për të.

Vizitë Studimore në Rumani

Përfaqësues të Fondacionit Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe përfaqësues të disa prej institucioneve të administratës publike, morrën pjesë në një trajnim-vizitë studimore, një javore, të organizuar nga Motivation-Romania dhe financuar nga USAID-FORECAST/ programi Shqipëri. Trajnimi kishte për qëllim përfitimin e njohurive teorike dhe praktike mbi aspekte të arritjes së qëndrueshmërisë për prodhimin e karrigeve me rrota në Shqipëri. Pjesëmarrësit në trajnim patën mundësinë për të diskutuar së bashku mbi elementët për hartimin e politikave efektive të asistencës sociale, me qëllim mbështetjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuar për karrige me rrota si dhe identifikimin e elementeve efektive për ngritjen e fondeve për prodhimin e karrigeve me rrota në Shqipëri. Gjithashtu, ky trajnim shërbeu edhe për identifikimi dhe diskutimin e politikave në fushën e shërbimeve shëndetësore, si një nga skemat efektive për sigurimin e mbështetjes të individëve me aftësi të kufizuar për karrige me rrota. Drejtuesja ekzekutive, përfaqësuesja ligjore, inxhinjeri si dhe koordinatoresha për ngritjen e fondeve pranë FSHDPAK, përfaqësuesja e Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta dhe Presidenti i Shoqatës Kombëtare të Invalidëve të Punës hartuan një plan veprimi për ndërhyrje në nivel qëndror/ vendor me qëllim fuqizimin e qëndrueshmërisë dhe mbështetjen e përdoruesve të karrigeve me rrota nga strukturat përgjegjëse.



Rasti Korçë

R.L. 42 vjeç, banore në një nga komunat periferike pranë qytetit të Korçës vuan prej disa vitesh probleme të shëndetit mendor. Për shkak të kësaj gjendjeje ajo është braktisur nga bashkëshorti, i cili nuk tregon asnjë lloj kujdesi për të dhe për fëmijët e tyre 16 dhe 18 vjeçar.

Gjendja e vështirë ekonomike e detyroi R.L. të kërkojë ndihmën ligjore të Degës së Programit Ligjor në Korçë, për shkak të vështirësive që po haste për tu trajtuar nga skemat e ndihmës ekonomike nga Bashkia Korçë. Duke qënë se R figuronte zyrtarisht e martuar, me burim të ardhurash nga bashkëshorti i saj, kjo përbente edhe një nga problemet kryesore të mospërfshirjes së saj në këtë skemë. Në këto kushte Avokate e Programit ligjor në Korçë, pasi u keshillua me R.L., filloi procesi gjyqësor për të zgjidhur fillimisht martesën e saj formale. Negocioi me bashkëshortin dhe djalin e saj 16 vjeç, në mënyrë që ata të ishin prezent në gjykim dhe procesi të mos kishte shtyrje për shkak të mosparaqitjes së paleve. Tashmë vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, dhe pasi u bë rregjistrimi në zyrën përkatëse të gjendjes civile, R me çertifikatën familjare ku tregohet gjendja e saj reale familjare ka aplikuar në institucionet përkatëse për tu trajtuar financiarisht me ndihmë ekonomike, për plotësimin e nevojave të saj jetike.



Revistë e Financuar nga: Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

ÇFARE ESHTË FSHDPAK

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, FSHDPAK është organizatë jofitimprurëse që prej vitit 1994, fillimisht si program i Oxfam-it për aftësinë e kufizuar në Shqipëri, dhe regjistruar prej vitit 1996 si një OJF e pavarur. Filozofia e FSHDPAK mbështetet në modelin social të aftësisë së kufizuar.

Misioni i FSHDPAK është promovim i shanseve të barabarta dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre.

STRATEGJIA

Për realizimin e misionit të tij FSHDPAK punon ngushtësisht me individë me aftësi të kufizuar dhe shoqata të tyre, shoqata që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe aktore të tjerë të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore e private, përmes zgjerimit e fuqizimit të partneriteteve, duke synuar në zhvillimin e fuqizimit të procesit të avokatisë e vet-avokatisë nëpërmjet informacionit, trajnimeve, ekspertizës ligjore e teknike dhe shërbimeve të tjera.

Programet e FSHDPAK ofrojnë

- Informacion në fushën e aftësisë së kufizuar
- Trajnim, Konsulencë dhe Ekspertize teknike
- Avokati dhe lobim me synim përmirësimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar
- Asistencë ligjore dhe avokat falas për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre
- Prodhim dhe shpërndarje të karrigeve me rrota (e vetmja e këtij lloji në Shqipëri)
- Kampe të Rehabilitimit Aktiv për përdoruesit e karrigeve me rrota
- Punësim për njerëzit me aftësi të kufizuar
- Realizim i fushatave ndërgjegjësuese përmes medias.

SFIDA 29

BASHKËPUNËTORE

Blerta Çani
Bardhylka Kospiri
Narbis Ballhysa
Florida Kalemi
Entila Zyba
Eftali Xoga

DESIGN AND LAYOUT

Orest Muça

ADRESA

Rruga "Bogdani" (ish-A.Z.Çajupi) nr. 15,
kat i 3, Tiranë Shqipëri.

Tel: + +355 4 269426

E-mail: adrf@albmail.com

www.adrf.org.al